



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

RREGULLORE
PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NGA DUKURITË QË
DËMTOJNË SHËNDETIN DHE ZHVILLIMIN E TYRE

Maj 2011

Në bazë të nenit 12 nën (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Konventës për të Drejtat e Fëmijëve të miratuar nga Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, nenit 9,9.6 ,9.7 të Ligjit për Duhanin nr .02/L-36 ,nenit 61,61.1,61.2 të Ligjit për Veprimtari Hoteliere dhe Turistike nr. 2004/16 dhe Statutit të komunës së Hani i Elezit ,Kuvendi I Komunës në mbledhjen e mbajtur më _____miratoi këtë:

**RREGULLORE
PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NGA DUKURITË QË
DËMTOJNË SHËNDETIN DHE ZHVILLIMIN E TYRE
DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME**

Përkufizimet

Neni 1

- 1.1** .Të mitur konsiderohen personat prej moshës 14 deri në 18 vjet.
- 1.2** . Personat prej moshës 14- 16 vjet konsiderohen të mitur të rinjë,ndërsa personat prej moshës 16 deri 18 vjet janë të mitur të rritur.
- 1.3** . Dispozitat e kësaj rregullore vlejnë edhe për personat nën moshën 14 vjeçare.
- 1.4** . Dukuri negative që dëmtojnë shëndetin e të miturve konsiderohen konsumimi I alkoolit,duhanit,narkotikëve të ndryshëm,shfaqjet degjeneruese ,frekuentimi I të rinjve në lokalet e ndryshme në orët e vona etj.
- 1.5** . Vendet publike janë hapësirat,lokalet e ndryshme hoteliere shërbyese dhe tregtare,institucionet kulturore,objektet edukativo-arsimore,kinematë dhe lokalet e natyrës së tillë.

**Shitja dhe shërbimi me pije alkoolike dhe duhan të miturit
Neni 2.**

- 2.1** . Ndalohet rreptësishtë shitja dhe përdorimi I të gjitha pijeve alkoolike dhe duhanit Brenda objekteve edukativo-arsimore.
- 2.2** Të gjitha subjektet nga neni 1.5. të kësaj Rregullore janë të obliguara që në hyrje apo brendi të vendosin tabelën (shenjën) për ndalimin e shitjes dhe shërbimit të pijeve alkoolike dhe duhanit për të mitur, konformë dispozitave të kësaj rregullore.
- 2.3** Ndalohet shitja dhe shërbimi i pijeve alkoolike për te miturit nga subjektet afariste.
- 2.4** Ndalohet shitja dhe shërbimi më duhan apo çdo lloj tjetër i duhanit të miturve nga subjektet tregtare që merren me shitjen dhe shërbimin e tyre.
- 2.5** Ndalohet rreptësishtë personave nën moshën 16 vjeçare të shesin pije alkoolike dhe duhan.

**Obligimet e subjekteve afariste dhe të miturit
Neni 3**

3.1 Të miturit nën moshën 16 vjeçare mund të qëndrojnë në lokalet në të cilat shërbehet alkooli vetëm në prani të prindit ose kujdestarit ligjor.

3.2 Të miturit e rritur mund të qëndrojnë deri në orën 20.00 ,ndërsa pas orës 20,00 vetëm në prani të prindit apo kujdestarit ligjor.

3.3 Në lokalet në të cilat luhen lojërat si: loto, bingo, prognoza sportive, apo lojëra fati ndalohet hyrja e të miturve.

3.4 Organizatorët e shfaqjeve të ndryshme, programeve dhe manifestimeve publike dhe kulturore për te rinjtë në lokalet e mbyllura janë përgjegjës në rast se në ato lokale lejon përdorimin e pijeve alkoolike apo duhanit nga të miturit në kundërshtim me dispozitat kësaj rregullore .

Kinematë, Internet kafetë dhe shtypi

Neni 4

4.1 Kinematë apo subjektet tjera që merren më shfaqje publike të filmave janë të detyruara që për fëmijët deri në moshën 14 vjeçare ti shfaqin ato deri në ora 18.00, prej moshës 14 deri në 16 vjeçare deri në ora 20.00,ndërsa për te miturit prej 16 deri në 18 vjet deri në ora 22.00.

4.2 Pas orës 22.00 shfaqjet të tilla të miturit mund t'i përcjellin vetëm në prani të prindit apo kujdestarit ligjor.

4.3 Kinematë, apo subjektet tjera janë të obliguara që me rastin e shfaqjes së filmave, përmbajtja e të cilave ndikon negativisht në formimin e të miturve në aspektin edukativ, arsimor dhe kulturor, të njoftojnë me rastin e reklamimit të filmit si dhe në hyrje të objektit ta kenë shenjën për ndalimin e hyrjes dhe njëkohësisht është i obliguar që të mos lejojë hyrjen e tyre.

4.4 Internetet kafetë janë të obliguara që ti ndalojnë hapjen e Web-faqeve të cilat ndikojnë negativisht në formimin e personalitetit dhe edukimit të tyre.

4.5 Botuesit dhe shitësit e revistave të ndryshme, përmbajtja e të cilave është degjeneruese dhe ndikojnë negativisht në edukimin arsimor, shëndetësorë dhe kulturor të te miturve nuk mund ti shesin të miturve deri në moshën 18 vjeçare .

4.6 Video klubet apo subjektet tjera që merren me shitjen e videokasetave, DVD-ve, CD-ve, përmbajtja e të cilave është degjeneruese janë të obliguara që të mos u shesin apo përdorimin e tyre nga të miturit.

Neni 5

5.1 Inspektorët Komunal dhe policia do të kujdesen dhe të mbikëqyrin zbatimin e kësaj rregullore nga subjektet përkatëse dhe do të ndërmarrin masat dhe veprimet përkatëse sanksionuese.

Dispozitat ndëshkuese dhe gjobat

Neni 6

6.1. Pronari i lokalit nëse në lokalin e tij shet ose shërben pije alkoolike në kundërshtim me dispozitat nga neni 2 të kësaj Rregulloreje, do të dënohet me

gjobë prej 500-2.500 € të përcaktuar në nenin 103 pika (l) të Ligjit për veprimtari hoteliere dhe turistike (**Ligji nr.2004/16**).

6.2. Me gjobë në shumë prej 200 €do të dënohen:

- Nëse të miturit i lejohet qëndrimi në restorant apo kafiteri etj. në kundërshtim me dispozitat neni 3 par. 1 dhe 2 të kësaj rregullore.
- Nëse subjektet nga neni 3 par. 3 veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore.
- Organizuesit e shfaqjeve, manifestimeve etj, veprojnë në kundërshtim me dispozitat nga neni 3 par. 4 të kësaj rregullore.

6.3. Me gjobë ne shume prej 100€do të dënohen:

- Nëse subjektet nga neni 4, veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore.
- Do të dënohet personi përgjegjës i Institucionit Edukativo–Arsimor, nëse nuk respektohet dispozita e nenit 2.1.

Dispozitat kalimtare dhe te fundit

Neni 7

Nëse subjektet nuk bëjnë pagesën e gjobave të shqiptuara në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore do të iniciohet procedura kundërvajtësve pranë Gjykatës komunale për kundërvajtje.

Neni 8

Të gjitha mjetet e arkëtuara nga shqiptimi i masave ndëshkuese do të derdhen në Buxhetin komunal.

Neni 9.

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit

Menduh Vlasi